

Prof. Dr. Sulltane KOJÇINI-UKAJ

ROLI I ZHUK HAXHISË NË QËNDRESËN KOMBËTARE TË RUGOVËS

Rezistenca kombëtare (gjatë shek. XX) që kishte për synim çlirimin dhe bashkimin e tokave shqiptare, kaloi nëpër disa etapa kohore: Lëvizja Kaçake (1918-1941); Lufta e Dytë Botërore (1941- 1945); NDSH-ja (1945-1947).

Zhuk Haxhija ishte luftëtar i orëve të para në të gjithat etapat e rezistencës kombëtare. Ai ishte luftëtar i dalluar dhe pasardhës i denjë i familjes së tij të njohur në fshatrat e Rugovës që nga Lidhja e Prizrenit. Që në moshë të re u dallua për mençuri dhe trimëri, cilësi këto të trashëguara nga gjyshërit Çelë Shabani e Haxhi Çela. Çela ishte pjesëmarrës i Lidhjes së Prizrenit në vitin 1878, ndërsa Haxhiu njëri ndër udhëheqësit e rezistencës kombëtare të kohës së tij në Rugovë. Zhuka u lind në katundin Stakaj të Rugovës në vitin 1885. I brumosur me ide kombëtare nga të parët e tij që lanë gjurmë të pashlyeshme në historinë e mbrojtjes së Rugovës dhe të viseve të tjera shqiptare, që nga viti 1907 Zhuka u dallua dhe u bë i njohur me aktivitetin e tij politik e ushtarak, duke u bërë një figurë me autoritet në Rugovë dhe në Rrafsh të Dukagjinit. Mori pjesë në luftërat që u zhvilluan në Majë të Lamës kundër malazezëve, në të cilën edhe u plagos, si dhe në luftërat që u zhvilluan në Beranë në vitin 1912 dhe në atë të Moknes.¹

Rezistenca aktive e kryengritjeve të njëpasnjëshme që bënë shqiptarët kundër pushtuesit jugosllav, e cila në histori njihet me emrin Lëvizja Kaçake, kaliti edhe më tepër karakterin e tij luftarak të një strategu me përvojë politike e ushtarake, por edhe me një forcë mobilizuese të fjalës. Në vitet e rezistencës kombëtare 1918-1924, atëherë kur vendit i kanosej rreziku nga okupatori serb që pasojë me

¹ Fazli Muriqi ,Qëndresa rugovase dhe Sak Fazlia (Bajraktar i Rugovës) 1911-1944, Gjakovë, f.117.

vrasje, djegie e shpërngulje të mëdha, Zhuka ishte ndër luftëtarët e dalluar jo vetëm të kësaj ane, por dhe më gjerë.² Për autoritetin që gëzonte në këto anë, në vitin 1930 rugovasit e zgjodhën kryetar të tyre. Në këtë detyrë qëndroi pesë vjet dhe pasoi Shaban Rexhën, njeriun po ashtu me ndikim në këto anë. Sa ishte në detyrën e kryetarit të Rugovës, Zhuka ishte kyçur në Partinë Demokratike të Jugosllavisë borgjeze. Ato vite në Parlamentin e Jugosllavisë borgjeze delegat nga Peja ishin Sefedin Begolli dhe Jojoiqi.³ Gjatë kohës sa kishte qenë anëtar i PD të Jugosllavisë Zhuka kishte zhvilluar aktivitetin e tij politik brenda Rugovës dhe në Dukagjin, duke bërë propagandë aktive në mobilizimin e shqiptarëve kundër një regjimi diskriminues, që Jugosllavia borgjeze zbatonte ndaj shqiptarëve. Për këtë qëllim ai ishte marrë shpesh në pyetje nga pushtetarët, të cilët i kërcënoheshin më burgim e me masa të tjera ndëshkimi kinse për “mostolerancë ndaj Jugosllavisë borgjeze”.⁴ Pas zgjedhjeve të vitit 1935, kur në Parlamentin e Jugosllavisë borgjeze fituan radikalët dhe kur delegat ishte emëruar Nedelko Simoviq, Zhuk Haxhija ishte pushuar nga posti i kryetarit të Rugovës dhe ishte tërhequr krejtësisht nga politika. Në Rugovë tanimë këtë detyrë e kryente Hilmi Beqa dhe pas tij Bek Zhuja.⁵ Duke ia njohur tiparet e tij burrërore e fisnike, shpirtin luftarak, e duke ditur se fjala e tij ishte me ndikim në Rugovë e në Dukagjin, xhandarmëria jugosllave asnjëherë nuk e la të qetë, por lëvizjet e tij përcilleshin me syçeltësi nga organet e pushtetit të regjimit në fjalë. Ky ishte edhe shkaku që Zhuka të tërhiqej për një kohë nga aktiviteti i tij politik legal, duke mos e ndalur asnjëherë aktivitetin e vet në rezistencën e armatosur shqiptare. Në mënyrë që të binte në sy të pushtetit dhe të mos hetohej aktiviteti i tij ilegal në qëndresën kombëtare, ai një kohë iu kthye familjes dhe profesionit të bujkut.

Menjëherë pas kapitullimit të Jugosllavisë, duke parë rrethanat politike që zhvilloheshin me shumë të papritura, paria e Pejës fillon bisedimet me komandën ushtarake jugosllave me çka u arrit të evitohen konfrontimet e hapta dhe gjakderdhja e shqiptarëve. Megjithatë, tërheqja e ushtrisë jugosllave nuk kaloi pa viktima, e cila vrau disa qytetarë të paarmatosur në Pejë, me çka nxiti rezistencën e armatosur të shqiptarëve të kësaj ane.

Sipas aktakuzës së Gjyqit të Qarkut në Prishtinë, në të cilën edhe mbështetemi në këtë punim e që gjendet në Arkivin e Kosovës, në këto rrethana të ndërlikuara Zhuk Haxhija ftohet nga xhandarmëria jugosllave

² Po aty, f. 117.

³ AK, Fondi Gjyqi i Qarkut në Prishtinë, LP. 66/47, Procesverbal i deklaratis së Zhuk Haxhisë të bërë në lokalet e SSH-së në Pejë, dt.5. 02.1947.

⁴ Po aty, f. 2.

⁵ Po aty.

në orët e vona të natës në bisedë të dhunshme konsultative për të kërkuar ndihmën e tij për tërheqjen e sigurt të ushtrisë jugosllave përgjatë rrugës Pejë-Çakorr, nëpër Rugovë. Xhandarmëria jugosllave kishte nevojë për angazhimin e Zhuk Haxhisë në sigurimin e rrugës për kalimin e ushtrisë jugosllave gjatë tërheqjes për në Mal të Zi. Për këtë qëllim, përveç Zhukës ishin ftuar edhe prijësit e tjerë rugovas. Xhandarmëria jugosllave kërkonte nga ta garantonin një kalim të qetë, të sigurt e pa konfrontime.⁶ Në të njëjtën kohë, paria e Pejës kishte ftuar krerët rugovas për të marrë pjesë në ndërtimin e pushtetit civil dhe atë të mbrojtjes së vendit. Në mesin e të ftuarve ishin Sak Fazlia, Isuf Mehmeti nga fshati Shtupel, Haxhë Zeka nga Shtupeli i Vogël, Dinë Zeka nga Allaga, Rustem Veseli nga Pepiqi, Rexhë Mustafa nga Malaj, Hysen Syla nga Bogaj, Col Sokoli nga Stankaj, Agan Seku e Fazli Zymberi nga Kuqishta dhe Tahir Abazi nga Drelaj.⁷ Edhe nga këta kërkoheshin garanci për sigurinë e ushtrisë jugosllave që duhej të tërhiqej për në Mal të Zi.

Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe rikthimi i Bedri Pejani në Pejë

Disa ditë pasi gjermanët hynë në Pejë, edhe pse me qëllime pushtuese, u krijuan kushte më të favorshme për realizimin e aspiratave të shqiptarëve për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Në këtë drejtim rol të rëndësishëm luajti Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe rikthimi i Bedri Pejani në Pejë. Ky atdhetar, edhe pse qëndroi një kohë të shkurtër në këtë prefekturë, u prit nga populli me një manifestim gjithpopullor. Riorganizimi i Komitetit Shqiptar në Pejë dhe në prefekturat e tjera të Kosovës tuboi rreth vete figurat më të ndritura të kombit që edhe më parë ishin angazhuar për çlirim dhe bashkim kombëtar. Bartësit e këtij Komiteti me në krye Bedri Pejanin biseduan me krerët e Pejës për organizimin e administratës civile, si dhe për mbrojtjen e kufijve të Kosovës. Bedri Pejani, në konsultim me krerët e Pejës, veçmas me Qerim Begollin, kishte vendosur që Rugova të marrë rolin e saj në mbrojtje të kufirit me Malin e Zi.

Bajraktari i Rugovës, Sak Fazlia, ishte ftuar në Pejë për t'u takuar me forcat ushtarake shqiptare, të cilat kishin arritur në Kosovë për mbrojtjen e kufijve etnikë. Për këtë qëllim KMKK vendosi që menjëherë të bëhet armatosja e vullnetarëve dhe sistemimi i tyre nëpër grupe e zona përkatëse.

Në maj të vitit 1941, pasi forcat italiane u vendosën në Pejë, Xhevat Begu e kishte ftuar edhe Zhuk Haxhinë të merrte detyrën e udhëheqësit të

⁶AK, Fondi Gjyqi i Qarkut, Dok i cit.

⁷Po aty, f. 2.

grupeve vullnetare. Si një personalitet me autoritet dhe me një përvojë politike e ushtarake, Zhuka ishte i angazhuar nga KMKK dhe prefekti i Pejës në vendosjen e rendit në Rugovë. Në këtë kohë kryetar i Rugovës ishte emëruar Haxhë Keri, i biri i Ker Sadri Bardhit i cili për 20 vjet kishte qenë në Shqipëri, përkatësisht në Fushë-Krujë i ndjekur nga sistemi Jugosllav,⁸ përkatësisht pas kryengritjes së vitit 1919, e cila u shua në muajin qershor dhe shumica e prijësve të kryengritësve u detyruan të strehonin familjet e tyre në Shqipëri për t'u shpëtuar masakrave serbe. Veprimtarët e kësaj rezistence të armatosur kohë pas kohe ktheheshin në Kosovë dhe vazhdonin aktivitetin e tyre luftarak e politik. Në këtë kohë familjet e tyre i shpërngulën Sadik Rama i Gjurgjevuikut, Zhuk Haxhija i Rugovës, Kera i Sadri Bardhit e shumë prijës të tjerë të rezistencës kombëtare. Kosovarët kryesisht u sistemuan në Fushë-Krujë, Mamuras, Malësi të Shkodrës, rrethinat e Durrësit, Fierit e të Lushnjës. Pas kapitullimit të Jugosllavisë, shumica prej tyre u kthyen në trojet e veta shekullore dhe vazhduan veprimtarinë politike e ushtarake. Për një organizim më efikas të forcave vullnetare ishte angazhuar edhe Rexhep Gjilani, kolonel i ushtrisë shqiptare dhe shumë kapitenë të tjerë.⁹ Pas disa tubimeve e konsultave me krerët e kësaj prefektуре, Peja që nga mesi i prillit kontrollohej dhe administrohej nga paria e saj.

Kështu, rrethanat që u krijuan gjatë LDB-së mundësuan bashkimin e një pjese të madhe të trojeve shqiptare në një shtet shqiptar. Vendosja e pushtetit shqiptar në rrethanat e Luftës së Dytë Botërore dhe caktimi i kufijve etnikë, për serbomalazeztë ishte të papranueshme. Në këto rrethana, si rrjedhojë e politikës antishqiptare gjatë 22 vjetëve të Jugosllavisë borgjeze, përfshirë këtu edhe kolonizimin e Kosovës me serbë e malazez që nga viti 1912, hendeku mes të shqiptarëve e serbëve u thellua edhe më shumë. Kjo ndikoi që shumica e serbëve dhe e malazezëve që në periudha të ndryshme kohore që nga viti 1912, e sidomos pas vitit 1918, ishin vendosur si kolonë në Kosovë, duke e ndier veten të pasigurt ikin së bashku me ushtrinë e policinë nga Kosova pas futjes së forcave gjermane. Peja ishte qyteti më i kolonizuar me malazez që nga viti 1918-1941. Pas vitit 1941 pjesa më e madhe e tyre ishin vendosur në Serbi e Mal të Zi, por gjithnjë afër kufirit shqiptar dhe ishin kyçur në formacionet partizane dhe çetnike të cilat shpesh bashkërendisnin veprimet kundër shqiptarëve në zonat kufitare. Formacionet çetnike të Drazha Mihajloviqit kishin formuar aradhen çetnike "Dukagjini". Veç kësaj, në kufi me Kosovën vepronin edhe

⁸ Po aty.

⁹ AK, Fondi ,Gjyqi iQarkut, Hetuesia e bërë me 28 ,ars, UDB-a Prishtinë.

aradhat e tjera çetnike të Pavle Gjurishiqit, të Kosta Peçancit e të tjera.¹⁰ Këto formacione shqetësonin popullatën shqiptare me sulmet dhe provokimet e shpeshta që bënin në zonat kufitare duke u futur shpeshherë edhe brenda kufijve të Kosovës. Bartësit më të shpeshtë të këtyre provokimeve ishin kolonët serbë dhe malazez që në vitin 1941 e kishin lëshuar Kosovën.

Rugova ishte rajoni më i afërt me Malin e Zi prej nga provokimet e çetnikëve ishin më të shpeshta. Kjo ishte edhe arsyeja e mobilizimit masiv të këtyre anasve në mbrojtjen e kufirit. Kështu kishte ndodhur edhe më herët që nga vitet 1912–1941 kur ky rajon i Rugovës ishte sulmuar vazhdimisht nga forcat malazeze

Forcat vullnetare të njësitit të Zhuk Haxhisë ishin të përqendruara nga qafa e Çakorrit

Forcat çetnike të ndihmuara nga ato partizane, shumica e pjesëtarëve të të cilave ishin kolonë që kishin lëshuar Kosovën pas futjes së forcave italiane, ishin vendosur në pikat kyçe të kufirit që për synim kishin sulmimin e Pejës. Duke e vëzhguar me vëmendje situatën e krijuar në kufirin me Malin e Zi, organizimi i forcave vullnetare ishte i ngutshëm dhe i domosdoshëm dhe sa më masiv. Për këtë qëllim ishin bërë disa organizime. Ishin formuar 6 batalione dhe kufiri ishte i ndarë në sektorë. Diç më shumë se 6 muaj Zhuka ishte komandant i 16 sektoreve.¹¹ Organizimi i parë kishte përfshirë afro 300 vullnetarë të ndarë në grupe. Grupi i parë të cilit i kishte prirë Rizë Zymberi ishte nisur për Murgash. Sali Rama, një strateg po ashtu me përvojë luftarake i kësaj ane, i kishte prirë grupit të dytë të vullnetarëve. Në të dyja grupet ishin përfshirë 2/3 e rugovasve, ndërsa të tjerët në grupin e tretë të cilit i printe strategu me përvojë Zhuk Haxhija. Ndërmjet forcave vullnetare për mbrojtjen e kufijve dhe formacioneve çetnike gjatë viteve 1941-1944 janë zhvilluar shumë beteja, si ato të Kolashinit, Smilovicës, Murgashit, Rozhajës, Novi-Pazarit, Shekullarit, Çakorrit, Tregovishtës, e në vitin 1945 edhe lufta kundër forcave partizano-çetnike në Shtedim.¹² Lufta më e rreptë në mbrojtje të kufirit ishte zhvilluar në Smilovicë ku vullnetarët kishin mbrojtur me sukses pikat e tyre kufitare. Në këto luftime, përveç humbjeve të mëdha të forcave çetnike, ishin vrarë edhe vullnetarët trima si Grosh Ibra e Ibish Selimi dhe tre pjesëtarë të ushtrisë shqiptare.¹³ Në këto pozita forcat vullnetare kishin qëndruar mbi një muaj. Veç këtyre

¹⁰ Dr. Muhamet Shatri, "Kosova" nr.22/23, .Prishtinë. 2003. f. 258.

¹¹ AK, Fondi Gjyqi i Qarkut, Hetuesia e dt.6.02.1947.

¹² Sylë Dreshaj, Prefektura e Pejës 1941-1944, Pejë 1998, f. 131.

¹³ Hetuesia e bërë më 28.03.1947.

njësiteve në Rugovë u formuan dhe vepruan edhe njësite të tjera vullnetare për mbrojtjen e kufirit, si njësitë e Haxhë Kerit e Din Zekës. Njësitet vullnetare rëndom kishin 50-100 veta. Forcat vullnetare të njësitit të Zhuk Haxhisë ishin të përqendruara nga qafa e Çakorrit deri të Kulla e Vogël në Mognë, zonë kufitare mjaft e sulmuar nga forcat çetniko-partizane. Përleshje të ashpra u zhvilluan po ashtu edhe në mbrojtjen e Plavës e të Gucisë. Për t'u bërë ballë kërcënimeve të vazhdueshme të forcave malazeze antifashiste dhe atyre çetnike në mbrojtje të Plavës e Gucisë shkuan edhe vullnetarët nga Kosova. Në këto përleshje prijësit e Rugovës dhe të Pejës u erdhën në ndihmë vëllezërve të tyre. Më të dalluar ishin Zhuk Haxhija, Sali Rama, Sak Fazlija, Rizë Zymberi, të gjithë nga Rugova, dhe Mon Belegu nga Peja. Zhuka mori pjesë edhe në shumë luftime të tjera përgjatë kufirit me Malin e Zi. Përleshje të përgjakshme mes forcave vullnetare për mbrojtjen e kufirit dhe atyre partizano-çetnike ishin zhvilluar në Shtedim në shtator të vitit 1945 ku ishin vrarë 9 partizanë.¹⁴ Në ato përleshje mori pjesë edhe Bajram Kojçini, bashkëluftëtar dhe pjesëmarrës i njësitit vullnetar të Zhuk Haxhisë. Për taktikën e tij luftarake e strategjike Zhuk Haxhija ishte dekoruar nga majori i ushtrisë shqiptare Rexhep Gjilani me gradën e majorit dhe të kryekapabandës.¹⁵ Zhuk Haxhija nuk ishte i arsimuar por dallohej për maturi, vizion të qartë dhe ishte i paluhatshëm në qëndrimet dhe veprimet e veta. Që nga viti 1943, kur ushtria italiane dhe ajo shqiptare tërhiqen nga kufiri, mbrojtja e kufirit iu besohet vetëm njësiteve vullnetare me paga simbolike prej 5-10 napolona ari shqiptare, ndërsa udhëheqësit e grupeve vullnetare paguheshin deri në 20 napolona shqiptare. Ushtria italiane, deri me kapitullimin e saj, mbetet vetëm në zonën e Çakorrit. Në rrethanat kur pushtuesit italian i shihej fundi, rugovasit e pranuan mbrojtjen e plotë të kufirit dhe për këtë qëllim u furnizuan me 500 pushkë dhe municion tjetër të nevojshëm.¹⁶

Prijësit e njësiteve vullnetare në mbrojtje të kufijve etnikë

Kjo rezistencë e njësiteve vullnetare vazhdoi deri në vitin 1944 dhe gjysmën e vitit 1945. Do theksuar se prijësit e njësiteve vullnetare si Zhuk Haxhija dhe Rizë Zymberi qëndronin gjithnjë në kufi, derisa vullnetarët ndërroheshin çdo 10 apo 15 ditë. Në vitin 1944 në mbrojtje të kufirit ishin mobilizuar afro 600 vullnetarë të ndarë në dy grupe. Njërin grup e mbikëqyrte Zhuk Haxhija, e që përfshinte 6 fshatra të Rugovës,

¹⁴ Arkivi Ushtarak i Serbisë, Fondi Odsek, Odeljenje zaštiti naroda, k/551.

¹⁵ AK. Dok I cit. Procesverbal i ballafaqimit të Zhuk Haxhisë me Sali Ramën, 14.03.1947, Pejë.

¹⁶ Po aty. Hetuesi e bërë më 17 mars, 1947, Pejë.

ndërsa tjetrin Rizë Zymberi me 7 fshatra po të Rugovës. Në këtë kohë bajraktar i Rugovës ishte Sak Fazlia.¹⁷

Luftime të ashpra kundër partizano-çetnikëve ishin zhvilluar edhe në Pepiq dhe Rekë të Allagës. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet njësiteve partizane dhe atyre çetnike kundër shqiptarëve ndikoi në luhatjen e orientimeve të një pjese të antifashistëve komunistë shqiptarë në Kosovë dhe në inkuadrimit të tyre në formacionet e rezistencës. Kjo u hetua veçmas pas kapitullimit të Italisë dhe amnestimit të çetnikëve (1943) nga ana e komunistëve. Amnestimi i çetnikëve u bë jo pse kishin ndonjë frikë ushtarake nga ta por për faktin se ua lanë duart e lira të vepronin kundër çdo shqiptari që mendonte ndryshe, qoftë ai edhe komunist. Zhgënjimin më të madh këto forca e përjetuan veçmas pas Konferencës së Bujanit, atëherë kur premtimet e bëra gjatë luftës për vetëvendosje jo vetëm që u anashkaluan, por edhe u sulmuan. Këto dy forca që vepruan gjatë Luftës së Dytë Botërore, edhe pse kishin synime kombëtare, zgjodhën rrugë të ndryshme veprimi. Nacionalistët kishin zgjedhur rrugën e bashkimit kombëtar të mbështetur në Lidhjen e Dytë të Prizrenit, që për rrethanat e kohës favorizoheshin edhe nga gjermanët, ndërsa antifashistët komunistë në ideologjinë komuniste-internacionaliste të mbështetur në BRSS.

Muajt maj-qershor të vitit 1945 ishin plot vështirësi për çetat e rezistencës kombëtare dhe për grupet e tjera që qëndronin në mbrojtje të kufirit të Kosovës. Brigadat partizano-çetnike, në bashkëpunim me OZN-në dhe vullnetarët e mobilizuar me dhunë edhe nga radhët e shqiptarëve, ndiqnin këmba-këmbës njësitet e rezistencës kombëtare. Mbretëronte një situatë e rëndë për popullin shqiptar në përgjithësi, e veçmas për luftëtarët e rezistencës kombëtare, që nuk ishin pajtuar me ripushtimin e Kosovës nga komunistët jugosllavë. Në rrethana të tilla ata u detyruan ta vazhdojnë rezistencën e armatosur. Në luftimet kundër ripushtimit sllav në fund të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945, përpjekjet ishin të mëdha por rrethanat të pavolitshme për nacionalistët shqiptarë të cilët kishin synim çlirimin dhe bashkimin kombëtar. Nacionalistët e këtij orientimi këto rrethana nuk i gjuhëzuan, por ata në forma të ndryshme të rezistencës aktive dhe propagandistike luftuan realitetin e krijuar. Për këtë qëllim në gusht të vitit 1945, në vendin e quajtur Lluga e Dan Martin Pjetrit ishin tubuar mbi 2000 prijës luftëtarë dhe mysafirë të çetave kryengritëse shqiptare të Kosovës, si dhe nga Shqipëria e Sanxhaku në Kuvendin e Dobërdolit. Në mesin e delegatëve ishte edhe prijësi i Rugovës dhe luftëtari i orëve të para të vullnetarëve për mbrojtjen e kufirit të Kosovës Zhuk Haxhija. Veç Zhukës, nga Peja mori pjesë edhe Islam Tabaku, bashkëluftëtar i Zhuk Haxhisë, si dhe Ukë

¹⁷ Po aty.

Sadiku, Ymer Berisha, Demë Ali Pozhari, Zef Gjindoda, Adem Shala, Zeqë Sokoli, Qazim Bajraktari, Marije Shllaku, Prek Shyti, Shaban Sadik Rama, Sadik Lutani, Alush Smaili, Ferat Kotiri, Njazi Alishani, Rexhep Xheli, Ilijaz Broja, Bikë Dresheviqi, Mustafë Ibishi, Shaban Boshnjaku etj.¹⁸ Ky tubim kishte për qëllim formimin e një strategjie të ngutshme dhe efikase në mbrojtje të Kosovës, pra organizimin e formacioneve dhe koordinimin e veprimeve të përbashkëta në luftë kundër brigadave partizane e çetnike, që bënë kërda mbi popullatën e pambrojtur shqiptare. Në këtë Kuvend u mor vendimi për bashkimin e të gjitha grupeve e lëvizjeve ilegale me një qendër udhëheqëse ushtarako-politike për veprime të mëtejme kombëtare- bashkimin e trojeve etnike, duke u mbështetur edhe në forcat anglo-amerikane. Në Kuvend mori pjesë edhe një oficer nga Shqipëria, një nga Anglia, që¹⁹ pati rastin të njoftohet me synimet, kërkesat dhe mospajtimin e nacionalistëve shqiptarë me ideologjinë komuniste. Për qëllimet e lartpërmendura, në tetor të vitit 1945 u lëshua edhe një proklamata e hartuar nga nacionalisti dhe intelektuali i dëshmuar Adem Gllavica, i cili në këtë kohë luftonte dhe vepronte në malet e Jezercit. Kjo proklamata, me rëndësi të veçantë kombëtare dhe politike, duhej të shumëzohet dhe të përhapej në tërë Kosovën, por edhe në viset shqiptare në Maqedoni. Rëndësia e Proklamatës qëndron edhe në faktin se ajo bëri jehonë edhe në qarqet ndërkombëtare të cilat qysh herët treguan interesim për ndryshim të sistemit në Shqipëri, që më vonë pasuan me zbarkimet e shumë nacionalistëve nga Kosova të inkuadruar në Misionin anglo-amerikan për rrëzimin e komunizmit në Shqipëri. Këtë e argumenton edhe përmbajtja e kësaj proklamate, në të cilën, mes tjerash, thuhet: *”Ne nuk jemi kundër asnjë ideologjie, por ideologjia jonë është ekzistimi i popullit shqiptar, i cili mund të bëhet i sigurt vetëm në një shtet shqiptar, ku do të përfshiheshin kufijtë e tokave shqiptare.”*²⁰ Proklamata pati jehonë tek populli shqiptarë i Kosovës dhe i Maqedonisë, por edhe të pushtetmbajtësit, të cilët kishin frikë nga një përsëritje e furishme e pakënaqësisë së popullit shqiptar të Kosovës, duke mos e anashkaluar edhe ndikimin e opinionit ndërkombëtar që vëzhgonte rrjedhat në Ballkan.

Për ta ngulatur rezistencën shqiptare pushteti i kohës nuk zgjodhi metoda e forma të dhunës. Ai filloi ndjekjen permanente të nacionalistëve shqiptarë që luftuan për çlirim e bashkim kombëtar në një

¹⁸ Jetish Kadishani, Qazim Bajraktari prijës i bajrakut të Astrazubit, Prishtinë, 2000, f. 177-179.

¹⁹ Po aty, f. 179.

²⁰ Dr. Sulltane Ukaj, Proklamata e atdhetarit Adem Selim –Gllavica, “Kosova” nr. 26, f. 285.

shtet demokratik properëndimor, duke i përdorur forcat partizane, ato të OZN-së dhe të UDB-së për shpartallimin definitiv të të gjithë atyre që nuk e përkrahnin sistemin komunist të kohës.

Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë në përndjekje të nacionalistëve shqiptarë

Për këtë qëllim nuk mungoi as koordinimi me forcat e shtetit shqiptar të Enver Hoxhës, të cilat u vunë në përndjekje të nacionalistëve shqiptarë, duke i ekstraduar ata tek organeve kompetente të Jugosllavisë. Në këto rrethana, braktisja e Kosovës nuk ishte e lehtë, ngase ekzistonin dy mundësi, të largimit nga Kosova, njëra rrugë që çonte në Shqipëri e që ishte me mjaft rreziqe, dhe tjetra në Greqi, e që po ashtu ishte me shumë sfida të kurditura nga forcat partizano-komuniste maqedonase. Të ndodhur para një situatë të vështirë, krerët e rezistencës u munduan edhe një herë t'i koordinonin veprimet e veta, por pa sukses. Në shtator të vitit 1945 në kufirin me Shqipërinë, Muharrem Bajraktari ftoi krerët kosovarë, nëpërmjet Ejup Binakut, dhe ata të Plavës e Gucisë, për koordinim të mëtejshëm të veprimtarisë. Mirëpo mundësitë për rezistencë aktive ishin ngushtuar dhe pothuajse ishin bërë të pamundura, ngase grupet e rezistencës ishin shkëputur nga njëra-tjetra çka ndikonte edhe në moskoordinimin e veprimeve të përbashkëta ushtarake e politike. Për këtë qëllim në këtë tubim të krerëve të rezistencës shqiptare, në mes tjerash, u shqyrtua edhe mundësia e kalimit në Greqi. Në tubim morën pjesë Demë Ali Pozhari, Mehmet Agë Rashkoci, Ramë Binaku; grupin e Rugovës e përfaqësonin Zhuk Haxhija dhe Bekë Rexha, ndërsa nga Plava kishin arritur Llan Peqini dhe Adem Shabani. Prezent në këtë takim ishte edhe Ramë Muja nga Shqipëria. Muharrem Bajraktari, edhe pse vetë e kishte caktuar takimin me krerët e rezistencës, për shkak të obligimeve që kishte pasur në Mirëditë nuk kishte mundur të vinte.

Veç prijësve të rezistencës kombëtare në këtë takim kishin marrë pjesë edhe përcjellës të tjerë, numri i të cilëve vlerësohet në afro 40.²¹ Takimin e krerëve të nacionalistëve shqiptarë (që sipas procesverbalit të hetuesisë ishte mbajtur më 28 tetor 1946) e kishin zbuluar forcat partizane që gjithnjë ishin në ndjekje të tyre. Kështu ishte shkaktuar një përlëshje e armatosur midis forcave të rezistencës kombëtare dhe atyre partizane. Duke parë situatën e krijuar pas këtij takimi dhe pas përlëshjes me forcat partizane, dhe duke dashur që ta kursejnë popullin nga dhuna permanente e forcave të OZN-s dhe të UDB-së, grupet e rezistencës vendosen që të kalonin kufirin shqiptaro-shqiptar, me shpresë se do të

²¹ AK.Fondi cit. Hetuesia e bërë në lokalet e SSH-së në Prishtinë më 27 mars 1949.

gjenin strehim në Shqipëri. Edhe kjo rrugë ishte me plot rreziqe ngase Jugosllavia e kishte intensifikuar mbikëqyrjen e kufirit meqë kalimet për në Shqipëri ishin të shpeshta. Këtij grupi në të cilin ishte edhe Zhuk Haxhija me luftëtarët e tjerë të Rugovës, gjatë kalimit për në Shqipëri iu përgatit edhe një pritë tjetër në malet e Tropojës me ç'rast kishte pasur shkëmbim zjarri midis forcave nacionaliste dhe atyre komuniste.

Me qëllim të shpartallimit të çdo celule të rezistencës kombëtare aksionet e forcave të koordinuara çetniko-partizane dhe të atyre partizane brenda kufirit shqiptar vinin duke u intensifikuar gjithnjë e më shumë. Kjo tregon për një bashkëpunim të ngushtë e sistematik të dy shteteve në ndjekjen dhe përcjelljen permanente të nacionalistëve të çdo krahu, që për kohën ishin futur nën ombrellën balliste. Këto konstatime vërtetohen edhe nga materiali që gjendet në Arkivin Ushtarak të Serbisë, në të cilin, veç tjerash, thuhet: "Para një kohe nga Shqipëria janë sjellur 28 ballistë, të cilët më parë u janë dorëzuar pushtetit shqiptar. Nga bisedat informative, që kemi zhvilluar më ta kemi marrë informata edhe për të tjerët, që atje jetojnë në ilegalitet apo në gjysmlegalitet. Ne duhet sa më parë të kërkojmë ekstradimin e tyre në Jugosllavi. Jemi të njoftuar se Sali Mani, deputet i rrethit të Tropojës, i ka marrë në besë këta të arratisur, të cilët më parë i kishte çarmatosur, duke ia dorëzuar armatimin pushtetit të shtetit shqiptar."²² Kështu u veprua vetëm me ata që u legalizuan, ndërsa të tjerët nuk pranuan t'i dorëzojnë armët. Këtë grup të arratisurish, që kryesisht ishin nga Rugova e Peja, sa ishin nën mbrojtjen e Sali Manit e vizitoi kapiteni i ushtrisë shqiptare Idriz Rexhepi, nip i Sali Manit, si dhe Ukë Beqiri, kryetar i rrethit të Qerremit. Pas konsultimeve dhe bisedave të zhvilluara, disa prej tyre u legalizuan, ndërsa të tjerët, kryesisht prijësit e grupeve të rezistencës kombëtare, mbetën nën mbikëqyrjen e Sali Manit në Malësinë e Madhe. Ukë Beqiri pas bisedave dhe konsultimeve paraprahe edhe me organet e pushtetit të shtetit shqiptar, lëshoi fletëqendime për të mbetur në Shqipëri për këta vullnetarë: Smail Beka nga Shtupeli, Bajram Kojçini nga Peja, Metë Gomarica nga Peja, Shaban Alia nga fshati Koshutan dhe Ragip Nurkoviç. Të përmendurit, sipas këtij dokumenti, kishin kërkuar të kalonin në Shkodër ngase, siç kishin deklaruar, "kanë të afërmit e tyre atje".

Këtij grupi i ishin bashkuar edhe Qazim Vraga nga Istogu, Cen Ujkani nga Pepiqi i Pejës, Mustafë Hyseni dhe një boshnjak nga Rozhaja emri i të cilit nuk është bërë i ditur. Të gjithë këta që qendruan në Shqipëri u ndoqën këmba-këmbës nga pushteti i shtetit shqiptar, duke i futur me dhunë në shërbime të ndryshme të spiunazhit. Njëri nga ata që u arratisën në Shqipëri, duke menduar se do të gjejë strehim në tokën

²² A Serbisë, Fondi, Odeljenje zastite naroda, Dok i cit.

shqiptare, ishte Bajram Kojçini nga Peja për fatin e të cilit nuk dihet gjë edhe pas 60 vjetësh. Mirëpo, kishte raste jo të rralla ku shteti shqiptar në bashkëpunim me atë jugosllav kishte marrë vendim që të ekstradoheshin në Jugosllavi shumica e nacionalistëve shqiptarë pjesëmarrës në rezistencën kombëtare, ngase, siç shpreheshin organet përkatëse, “kishin bërë krime”. Këtu bënin pjesë: Zhuk Haxhija, Rizë Zymberi, nga fshati Koshutan, Sali Rama nga Trebovici i Pejës, Manush Begolli nga Peja, Ismail (Malë) Jusufi nga Zaratrat e Pejës, Agan Seka nga Haxhaj i Pejës, që ishte nga familja e Zhuk Haxhisë, si dhe Ker Sadria nga Kuqishta e Rugovës. Organet jugosllave të zbulimit jepnin në detaje edhe karakteristikat fizike të secilit individ në mënyrë që të identifikoheshin më lehtë.²³

Nacionalistët shqiptarë nga Kosova në Shqipëri u ndoqën këmba-këmbës!

Zhuk Haxhija dhe grupi i tij, të gjendur në një situatë të pafavorshme edhe në shtetin shqiptar, të ndjekur këmba-këmbës nga komunistet e dy shteteve, pas qëndrimit disamujor në Shqipëri vendosi të kthehet në Kosovë edhe pse kishte mundësi ta lëshonte vendlindjen e të strehohej në atë vend, si shumë shokë të tjerë të idealit. Me grupin kthehet në Rugovë për të qëndruar pranë popullit për të cilin luftoi dhe pranë familjes e cila në këtë kohë hiqte të zitë e ullirit nga pushtetarët komunistë. Deri në vitin 1947 Zhuka me shokë qëndroi në malet e Rugovës, duke lëvizur prej një fshati në tjetrin në kushte shumë të vështira dhe i ndjekur nga UDB-a e OZN-a. Këta luftëtarë të rezistencës kombëtare i furnizonin me bukë vetë fshatarët, të cilët për këtë veprimtari e solidaritet ndëshkoheshin me masat më të rrepta nga pushteti i ri komunist. Në grupin e Zhuk Haxhisë ishin edhe Sali Rama, Bekë Rexhepi, Isuf Rexhepi, Jonuz Buli, Rexhep Tahiri e Shaban Zhuka.²⁴ Duke parë ngushtimin e mundësisë së veprimit të tyre dhe keqtrajtimet që u bëheshin familjeve shqiptare, e sidomos të atyre që ishin në arrati, Zhuk Haxhija me shokë iu dorëzuan pushtetit më 25 janar 1947. Vendimin për dorëzimin e tyre e arsyetojnë edhe në hetuesi, duke deklaruar se “qëndrimi ynë i mëtejshëm në malet e Kosovës së gjakosur ishte shkas për gjakosje të reja, gjakosje të familjeve tona, prandaj zgjodhëm rrugën e dorëzimit, duke i marrë në konsideratë edhe pasojat.”²⁵

²³ Po –aty.

²⁴ Fazli Muriqi, vep. E cit. f.117.

²⁵ AK, Fondi Gjyqet, Dok I cit.

Zhuka edhe gjatë hetuesisë mbrojti me dinjitet veprën e tij kombëtare

Pas arrestimit të Zhuk Haxhisë dhe grupit të tij, ai u dërgua në burgun e Pejës e pastaj të Prishtinës. Në burgun e Pejës përjetoi torturat dhe keqtrajtimet më çnjerëzore nga udbashët Gojko Medenica dhe Alo Aloviq. Hetuesia e parë filloi më 6 janar 1947 në lokalet e Sigurimit Shtetëror në Pejë. Gjatë hetuesisë Zhuka kishte qëndrim burrëror edhe pse ishte i shtyrë në moshë, kishte 65 vjet. Asnjëherë nuk i akuzoi të tjerët, por me dinjitet mbrojti veprën që e kishte bërë duke marrë mbi vete gjithë barrën.²⁶ Ai ishte i vendosur dhe asnjë trysni nuk ia ndërronte deklaratën e dhënë, duke i qëndruar besnik veprimtarisë së tij dhe idealit për të cilin kishte luftuar. Po në këto lokale Zhuk Haxhija u mor në pyetje edhe më 27 fror dhe 14 mars 1947, ndërkaq në mars të vitit 1947 është dërguar në burgun e Prishtinës. Rrethanat në burgun e Prishtinës nuk ndryshonin shumë nga atë të burgut të Pejës. Vetëm udbashët ishin të tjerë. Në Prishtinë për herë të parë u mor në pyetje më 28 mars 1947 nga udbashi Nazmi Kursani.

Në seancat gjyqësore kundër tij si dëshmitarë u paraqitën shumë kolonistë malazezë për ta ngarkuar sa më shumë me vepra të bëra e të pabëra, si vrasje të grave dhe fëmijëve që Zhuka kategorikisht e mohoj duke u shprehur se *“nuk është në moralin tonë luftarak të vrasim gra dhe fëmijë”*.

Në Prishtinë Zhuka doli para gjyqit dhe u dënua bashkë me 15 të akuzuarit shqiptarë, emrat më eminentë të rezistencës kombëtare, si Ukë Sadiku, Ajet Gergurin, Gjon Serreqin, Hilmi Zariqin etj. Ai u dënua me aktvendimin e Gjyqit të Qarkut në Prishtinë nr. K-66/47 të datës 30 prilli 1947 me 20 vjet heqje lirie, burgim të rëndë, duke i humbur të drejtat qytetare e politike, përveç atyre prindore.²⁷ Ky vendim merr formë të plotë me aktgjykimin e Gjyqit Suprem të Serbisë nr. KZ.-989/47 më 3 korrik 1947. Pas këtij vendimi të prerë Zhuka me shumë shokë të idealit ishte dërguar në burgun famëkeq të Nishit për të vuajtur dënimin. Sipas raportit të Shtëpisë korrektuese të Nishit të datës 8.IX. 1947 ku ai vuante dënimin, në mes tjerash, thuhet se” Zhuka është me shëndet të mirë, mirëpo nuk do të punojë, saboton punën, nuk është i disiplinuar dhe për këto arsye është ndëshkuar disa herë, mirëpo dënimi tek ai nuk ndikon fare dhe për këtë shkak ai asnjëherë nuk mund të amnistohet. Gruaja e Zhukës, Suta, u bëri disa herë kërkesë për amnisti Presidiumit të Kuvendit Popullor të RFPJ dhe organeve të tjera kompetente, por ato

²⁶ AK, Hetuesia e bërë në lokalet e UDB-së Pejë, me. 6.02.1947.

²⁷ AK, Fondi i cit.Dok. Hetuesi 7.05.1947.

ansjëherë nuk u morën në shqyrtim me arsyetim se” *nuk ka vend për amnisti*.”²⁸ Kërkesa për amnisti mbështetej, veç tjerash, në faktin se Zhuk Haxhija në mbledhjen e Këshillit Popullor të mbajtur në fillim të dhjetorit në fshatin Drelaj të Rugovës, ishte zgjedhur nga vetë populli i Rugovës kryetar i këtij organi.

Në këtë post Zhuk Haxhija kishte qendruar vetëm 2 muaj dhe këtë fakt e pranoi edhe në hetuesi. Për emërimin e Zhukës në këtë post kishte kontribuar edhe Emrush Myftari. Sa kishte qendruar në këtë post ai kishte tubuar nga populli i kësaj ane një shumë prej 500 napolonash, 20 kuaj dhe 500 kilogramë mish ndihmë dedikuar pushtetit të kohës për nevojat e ushtrisë. Këto ndihma i ishin dorëzuar KP të rrethit të Pejës. Këtë e dokumentojnë edhe nënshkrimet e anasve të Rugovës të mbledhura më 30 XII 1947, që kishin për qëllim dëshminë për amnistimn e tij. Në këtë dokument që gjendet në Arkivin e Kosovës janë nënshkruar 115 kryefamiljarë rugovas.²⁹ Kërkesa për amnisti nga ana e bashkëshortes së Zhukës, Sutës, ishin bërë pa reshtur që nga viti 1947 e deri me lirimn e tij. Do theksuar se sa qëndroi në mal Zhuka me grupin e tij në krye të forcave kryengritëse iu internua familja, të cilën e mbajtën në Gjilan.³⁰

Konfiskimi i pasurisë si masë ndëshkuese kundër nacionalistëve!

Njëra ndër format e pushtetit të kohës për varfërimin e shqiptarëve deri në skajshmëri ishte aksioni i ndërmarrë gjatë viteve 1945-1948 për konfiskimin e pasurisë së “tepërt”. Sekuestrimi i pasurisë, e sidomos i drithit dhe mishit, dy artikuj kryesorë të jetesës, bëhej me motivacion se ushtria jugosllave kishte nevojë për ta. Ky aksion në Kosovë u zbatua në format më të vrazhdta, duke i dënuar të gjithë ata që nuk i përgjigjeshin atij. Konfiskimet e pasurisë deri te pragu i derës në kohën kur populli ishte tejet i rraskapitur nga lufta, zbatohej veçmas ndaj atyre që e kishin luftuar komunizmin dhe pushtetin e ri, e që në masë të madhe ishin burgosur, pushkatuar e internuar. Kështu u veprua edhe me familjen e Zhuk Haxhisë.

Vendimin për konfiskimin e pasurisë së Zhuk Haxhisë e kishte marrë gjyqi i Rrethit të Pejës (vendimi nr. 228/46) në përbërje të gjyqtarit Velisha Miqkoviç dhe proces mbajtësit Shaip Cernovërshanin me këtë arsyetim: Duke u mbështetur në nenet 3,4,5,6,9, 16, 20,23 dhe 28, i konfiskohet pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme armikut të popullit Zhuk Haxhia, i cili ishte arratisur në mal në vitin 1945.

²⁸ AK. Fondi Gjyqi I Qarkut në Prishtinë, Dok. 77/54.dt.26.05.1954.

²⁹ Po aty, Këto nënshkrime u bën me 30.XII. 1947 në Drelaj të Rugovës.

³⁰ Fazli Muriqi, vep. cit. f.117.

Ky vendim vlente edhe për dy djemtë e tij dhe nipin, të gjithë nga fshati Kuqishtë.

Me vendimin e Gjykatës së Pejës, Zhuk Haxhisë iu konfiskuan:

1. Pasuria e paluajtshme sipas listës poseduese nr. 10 të KK në Jashanicë këto parcela: 162, 21, 22, 27, 62, 63, 73, 90, 91, 153, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 173, 174, 175, 180, 243, 244, 252, 268, 287 dhe 288, male, luadhe dhe tokë të punueshme në vlerë prej 450.000 dinarësh. E tërë kjo pasuri gjendet në Rugovë.

2. Një mulli me tre gurë që gjindet në fshatin Zabergjë të K.P.V Treboviq me një arë e cila ka vlerë 30.000 dinarë.

Nga pasuria e luajtshme dy pela të vlerësuara 1200 dinarë, të cilat gjenden në fshatin Lutogllavë. Sipas aktvendimit për konfiskimin e pasurisë, e gjithë kjo pasuri e sipërshënuar shkon në dobi të fondit të Drejtorisë për të mira popullore.³¹

Pas viti 1966 në Jugosllavi ndryshuan rrethanat politiko-shoqërore, pra edhe në Kosovë. Ishte koha e një liberalizmi në politikë që reflektohej edhe në të drejtat e shqiptarëve. Duke i shfrytëzuar këto rrethana, si dhe duke u bazuar në të drejtën ligjore, avokati i mirënjohur shqiptar Bajram Kelmendi i bëri kërkesën e bazuar Gjyqit të Qarkut në Pejë nr. 138/69 më 11.12. 1968 për shqyrtimin e rikthimit të pasurisë së konfiskuar të Zhuk Haxhisë. Kërkesa u bë në emër të Sokol e Mustafë Çelajt kundër Kombinatit Bujqësor Industrial të Pejës, i cili kishte konfiskuar pasurinë e paluajtshme të Zhuk Haxhisë.³²

Zhuk Haxhija vuajti 13 vjet burg të rëndë nëpër kazamatet serbe, si në burgun e Nishit dhe atë famëkeq të Goli Otokut. Vdiq në Lutogllavë në vitin 1965 ku edhe u varros.

Ndriçimi i figurës së Zhuk Haxhisë pasqyron rezistencën kombëtare të disa periudhave historike, që më së gjysmë shekulli ishin mohuar në mënyra të ndryshme, e që në shumë raste merrnin edhe karakter antikombëtar.

³¹ AK.Dok. 77/54,. Aktvendim për konfiskimin e pasurisë.

³² AK. Dok. 138/68, dt. 11.XII. 1968, Pejë.

Dr. Sulltane KOJÇINI-UKAJ

SUMMARY

ZHUK HAXHIA'S ROLE ON NATIONAL RESISTANCE OF RUGOVA REGION

In national resistance period between 1918 and 1924, when Kosova was facing the danger of Serbian occupation followed by murders, burning and massive expulsion, Zhuka was among distinctive warriors of the region and beyond. In 1930 Rugovians appointed him for their chief leader. By his duty, a member of Democratic Party of Yugoslavia in opposition, he was noted for political activity inside Rugova and Dukagjin, for propagating Albanian mobilization against discriminatory regime that Yugoslav bourgeoisie applied towards Albanians.

Zhuk Haxhia as the proven strategist with political and military experience was charged from Kosova's Committee of National Defence to put the law and order in Rugova, and organize volunteers for defending the border.

Establishment of an Albanian rule in ethnical borders, for the WWII circumstances, was unacceptable for Serbians – Montenegrins. That had influenced attacks of cetnics, but also partisans in border areas very often. In these circumstances, Zhuka was appointed commander of Rugova volunteers in defending the border.

This resistance of voluntary units continued until 1944 and the first half of 1945. But, after the communist forces prevailed, the regime in power used unlimited sorts of violence against national resistance units and their families. Zhuka with his fighters was in Rugova Mountains, but he had to surrender on January 25, 1947 because of their families prosecutions. He was sentenced to 20 years imprisonment and with confiscation of possessions.

